



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1296/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI66/18

Parashtrues

Sahit Muçolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 276/2017, të 8 shkurtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sahit Muçolli, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ramiz Suka, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 176/2017] të 8 shkurtit 2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 2056/16] e 5 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 07/13] e 29 marsit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 4 maj 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 7 maj 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 16 maj 2018, Gjykata në pajtim me paragrafin 2, të rregullit 33 [Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit] të Rregullores së punës kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzon autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 22 maj 2018, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
10. Më 23 maj 2018, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
13. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese, në vend të gjyqtares Snezhana Botusharova.
14. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin nr. KSH. KI66/18 për zëvendësimin e anëtarit të Kolegjit shqyrtues Altay Suroy. Kolegji shqyrtues u ricaktua në përbërje të gjyqtarëve: Arta Rama-Hajrizi, Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci.
15. Më 29 tetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte kontratë pune prej 1 shtatorit 2009 deri më 31 gusht 2010, si mësimdhënës në shkollën e caktuar fillore. Përmes Vendimit [nr. 118-23963] të 17 shtatorit 2010 të Komunës së Prishtinës, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar se marrëdhënia e tij punës është shuar më 14 qershor 2010 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.
17. Më 3 janar 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë me padi kundër të paditurës, përkatësisht Komunës së Prishtinës, duke kërkuar realizmin e dy pagave, për muajt korrik dhe gusht në vlerën prej 552 euro dhe kamatën respektive prej 3,5%. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se ka punuar edhe dy muaj pas pensionimit, dhe se, për këtë arsye atij i takonte e drejta në kompensimin e dy pagave të papaguara.
18. Më 29 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 07/13], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore në Prishtinë konstatoi se parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar përmes Vendimit [nr. 118-23963] të 17 shtatorit 2010 se në datën e caktuar, përkatësisht më 14 qershor 2010, marrëdhënia e tij e punës konsiderohet e përfunduar për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Gjykata Themelore shtoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte provuar se atij i takon e drejta në realizimin të dy pagave të papaguara për punën që ai kishte pretenduar se e ka kryer edhe dy muaj pasi që kishte arritur moshën e pensionimit.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe që lënda të kthehet në rivendosje.
20. Më 5 tetor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2056/16], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore.

21. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore “*ishte i drejtë dhe i ligjshëm*” sepse: a) nuk karakterizohej nga shkelje të së drejtës procedurale apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale; dhe b) se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për ndërprerje të marrëdhënies së punës të njëanshme apo të kundërligjshme; por, për “*shuarje*” të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit bazuar në ligjin në fuqi.
22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës sërish propozoi që aktgjykimet e kontestuar të anulohen dhe lënda të kthehet për rigjykim në instancën e parë gjyqësore.
23. Më 8 shkurt 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 276/2017], e hodhi si të palejuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme arsyetoi se kërkesa për revizion nuk ishte e lejuar sepse vlera e objektit të kontestit nuk kalonte shumën prej 3,000 €, siç është e përcaktuar me nenin 211 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [Rev. nr. 276/2017] i 8 shkurtit 2018 i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se kontrata e punës së tij ishte e vlefshme deri më 31 gusht 2010, ndërsa moshën për pension të pleqërisë e kishte arritur në qershor 2010. Si rezultat, ai pretendon se atij i takon e drejta që t’i paguhet dy paga për muajt që kishte punuar pas arritjes së moshës për pension të pleqërisë dhe se një gjë të tillë, kishin dështuar të vërtetojnë gjykatat e rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 276/2017] e 8 shkurtit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

30. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se gjykatat e rregullta kishin dështuar të vërtetojnë faktin që ai kishte punuar edhe dy muaj pasi kishte arritur moshën e pensionit, dhe rrjedhimisht i kishin mohuar kompensimin përkatës.

32. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
33. Gjykata gjithashtu vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
34. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
35. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe e Apelit kanë shpjeguar se në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk bëhet fjalë për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punës, por për shuarje të saj për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për dy paga të papaguara, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar ndonjë "provë" për të vërtetuar se ka punuar dy muaj pa u paguar. Kurse, Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë si të palejuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës sepse vlera e objektit të kontestit nuk kalonte shumë prej 3,000 €, siç është përcaktuar me nenin 211 të LPK-së.
36. Gjykata vëren se vendimet përkatëse të gjykatave të rregullta kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket natyrës së përfundimit të marrëdhënies së tij të punës, por edhe të refuzimit të kërkesës për kompensimin e të ardhurave, të cilat ai pretendon se i takojnë. Ato kishin arsyetuar dhe shpjeguar, ndër të tjera: a) pensionimin në bazë të fuqisë ligjore; b) dallimin ndërmjet moszbatimit të kontratës dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit sipas fuqisë ligjore; c) afatet dhe kushtet për paraqitjen e provave të reja; si dhe, ç) kriteret ligjore për paraqitjen e revizionit në Gjykatën Supreme.

37. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili ndër të tjera, përmban:

“Paditësi, me vendimin me nr.118-23963 të datës 17.09.2010, është njoftuar se për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, me datën 14.06.2010 i përfundon marrëdhënia e punës, prej kur i njëjti do të pensionohet ... Gjykata në bazë të provave të administruara gjeti se paditësi nuk ia provoi gjykatës se i takon e drejta në realizimin e dy pagave pas pensionimit sipas pretendimeve të tij se ka punuar edhe dy muaj pasi që është pensionuar nga ana e paditësit, nuk u ofrua asnjë provë tjetër e të cilën do ta bënte më të besueshme padinë dhe kërkesëpadinë e tij, andaj konform nenit 322.1 të LPK-së, refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

38. Ndërsa, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përcakton:

“Mosha mandatore e pensionimit të nëpunësit civil është 65 vjet, çka në këtë rast nuk kemi shprehje-ndërprerje të marrëdhënies së punës, në mënyrë të njëanshme nga e paditura në mënyrë të kundërligjshme, mirëpo kemi shuarje të marrëdhënies së punës për faktin se paditësi e ka arritur moshën për pension dhe se vendimi me nr. 03 Nr. 118-23963 i datës 17.09.2010, me të cilin është njoftuar paditësi se me datën 14.06.2010 i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës për pension, nuk nënkupton moszbatim të kontratës së punës, por nënkupton përfundim i marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore”.

39. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
40. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (*Ibidem*, rasti nr. KI118/17; po ashtu shih, rastin e Gjykatës nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
41. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është

drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).

42. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
43. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
44. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 tetor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi